

Nr. 31/11 Prot/ Nr. 4 Regj.

Durrës, më 7.5.2026

Drejtuar:

Media Ambientale "Ondra Ambientale"
Adresa postare: Rruga "Aleksandër Çopa", Durrës nr. 04, Kati 7
Kodi postar 2003, Durrës, Shqipëri
Adresa elektronike: media@hekurudha.al
C.C. Fax: +355 52 222 037

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion

Në zbatim të Ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, si dhe në përgjigje të kërkesës suaj të paraqitur në rrugë elektronike, më datë 29.04.2026, e regjistruar në regjistrin e "Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve", në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, me numër rendor 7, ju informojmë si më poshtë:

Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave (selia qendrore) është pronë e ligjshme e shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a., fakt i vërtetuar përmes Certifikatave të Pronësisë nr. 1115074 dhe nr. 1115073.

Në lidhje me pyetjet mbi mundësinë e prishjes, transformimit apo ndryshimit të funksionit të kësaj godine, ju informojmë se aktualisht nuk është miratuar asnjë vendimmarrje përfundimtare për prishjen apo transformimin e saj.

Çdo ndërhyrje e mundshme në pasuritë në administrim të shoqërisë realizohet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pas vendimmarrjeve përkatëse nga organet kompetente, si dhe në kuadër të politikave të zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.

Në këtë kuadër, "Hekurudha Shqiptare" sh.a. është aktualisht e fokusuar në projekte strategjike të modernizimit dhe zhvillimit të rrjetit hekurudhor, ndër të cilat përfshihen:

- rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA);
- përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës hekurudhore me standardet europiane;
- zhvillimi i integritetit të rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetet rajonale dhe trans-evropiane të transportit.

Për sa i përket pyetjeve mbi projekte konkrete të ndryshimit të funksionit të godinës, apo përfshirjes së palëve të treta, ju bëjmë me dije se deri në këtë moment nuk ka një projekt të miratuar që parashikon ndryshimin e funksionit të saj.

Gjithashtu, dokumentet dhe projektet që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore publikohen në përputhje me legjislacionin përkatës për transparencën dhe prokurimin publik dhe janë të aksesueshme përmes kanaleve zyrtare institucionale, përfshirë faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe njoftimet zyrtare të shoqërisë.

Synimi ynë është i qartë: një hekurudhë moderne, funksionale dhe në shërbim të qytetarëve, ku një pjesë e rëndësishme e këtij transformimi janë edhe stacionet dhe godinat e shërbimeve, të cilat administrohen dhe janë në pronësi të “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

Ky informacion jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Me konsideratë!

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Paula VATNIKAJ

